# DËSHMI ARKIVI

**A-478433**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | FMN dhe Banka e Shqipërisë vlerësojnë progresin e sistemit financiar shqiptar, infrastrukturë e modernizuar dhe institucione më të shëndetshme |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/29/fmn-dhe-banka-e-shqiperise-vleresojne-progresin-e-sistemit-financiar-shqiptar-infrastrukture-e-modernizuar-dhe-institucione-me-te-shendetshme/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 29 shtator 2026, 08:58:56 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 29 shtator 2026, 08:51:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 29 shtator 2026, 08:50:00 UTC → 29 shtator 2026, 08:52:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `3b40b075fa99d299c7870dddad403f7940e8a10d521cc68a247d5ab77daf483b` |
| TEKSTI | `68f5ed8d86b3ccd7de37e457f11ffc630d7db587361d8adecf691eaca2155511` |
| PAMJA | `85053458e7bb36c2d3d8d8274b8c635562455ad47eaa771c2e8429225f431af3` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `a95858b70ee5b19279fc5838f8e82e3c3f7a8e06eeea6c6a72c505d4300f3070` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `5542c6f376d7530e05241a95b291e64e02f5f89d799222f37a26423635f8fe31` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/a95858b70ee5b19279fc5838f8e82e3c3f7a8e06eeea6c6a72c505d4300f3070`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

EKONOMI TË FUNDIT

# FMN dhe Banka e Shqipërisë vlerësojnë progresin e sistemit financiar shqiptar, infrastrukturë e modernizuar dhe institucione më të shëndetshme

29/09/2026 10:51



**Sistemi financiar shqiptar ka shënuar përparim të ndjeshëm krahasuar me vlerësimin e mëparshëm të viteve 2013–2014.**

Konstatimi vjen nga misioni i përbashkët i Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore, në kuadër të Programit të Vlerësimit të Sektorit Financiar, FSAP.

Përmbyllja e vlerësimit u diskutua më ditën e djeshme në një takim me Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko, ku morën pjesë edhe drejtues të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Agjencisë së Sigurimit të Depozitave dhe Ministrisë së Financave.

Sipas përfaqësuesve të FSAP, Shqipëria tashmë ka institucione financiare më të shëndetshme dhe një sistem financiar më të diversifikuar. Vlerësimi evidenton gjithashtu modernizimin e infrastrukturës së pagesave, zgjerimin e ndërmjetësimit financiar dhe përdorimin më të madh të teknologjisë në ofrimin e shërbimeve financiare.

Në fokus të vlerësimit kanë qenë qëndrueshmëria e sistemit financiar ndaj rreziqeve dhe goditjeve, kuadri rregullator dhe mbikëqyrës, administrimi i krizave financiare, rreziku sistemik, siguria kibernetike, financimi në epokën digjitale dhe zhvillimi i tregjeve të kapitalit.

FMN dhe Banka Botërore kanë vlerësuar edhe përafrimin e ndjeshëm të kuadrit ligjor dhe rregullativ shqiptar me standardet e Bashkimit Evropian, çka sipas tyre ka krijuar kushte për një mbikëqyrje më efektive të sektorit financiar.

Në të njëjtën kohë, rekomandimet e FSAP synojnë forcimin e mëtejshëm të qëndrueshmërisë së sistemit financiar, përmirësimin e administrimit të rreziqeve dhe rritjen e rolit të sektorit financiar në financimin e ekonomisë reale.

Guvernatori Gent Sejko falënderoi ekipin e ekspertëve të FMN-së dhe Bankës Botërore për punën e kryer dhe theksoi rëndësinë e një vlerësimi të pavarur në këtë fazë të zhvillimit të sistemit financiar shqiptar.

Sejko deklaroi gjithashtu se rekomandimet e FSAP do të analizohen nga autoritetet shqiptare dhe do të përdoren për të mbështetur reformat e mëtejshme të sistemit financiar në periudhën afatmesme.

Në përfundim, palët e vlerësuan procesin si të suksesshëm dhe shprehën angazhimin për vijimin e bashkëpunimit dhe ofrimin e asistencës teknike në disa prej fushave të përfshira në vlerësim.

## Kryesore



**Trump mund të rikthejë ndalimin ndaj tre mediave, CNN, MS NOW dhe Politico i drejtohen gjykatës**
10:41

**Investigimi i Fiks Fare/ "Nëse Bela çon emrin…", Belinda Balluku ministre edhe pas shkarkimit. Dëshmitë ekskluzive të drejtorëve për "shefen"**
07:50

**Ekskluzive/ "Auditim në SHISH pas arrestit të Vlora Hysenit", zbardhen diskutimet në Këshillin e Sigurisë. Çfarë thanë kreu i SPAK dhe Kryeministri Rama**
07:00

**Dosja e SPAK për SHISH/ "Përgjegjësi morale dhe individuale ka", Grida Duma: Po përgjegjësinë politike kush e mban?**
06:44

**Kombëtarja shqiptare në Digitalb/ Maran merr vendimin, ja cilët lojtarë lihen në tribunë**
09:49

## Më të lexuarat

**Investigimi i Fiks Fare/ "Nëse Bela çon emrin…", Belinda Balluku ministre edhe pas shkarkimit. Dëshmitë ekskluzive të drejtorëve për "shefen"**

**BE, një "surprizë" për Shqipërinë/ E zbulon "Politico", do këtë strategji më vete për 4 vendet që janë pranë anëtarësimit**

**Fiks Fare/ "Belinda Balluku e ka vënë Enea Karakaçin". Drejtori i AKBN-së takime me ish-ministren deri në fund të gushtit: Do t'i çoj të fala**

**Video/ Nuk i dilte pensioni për të jetuar, ish-polici në Turqi merr vendimin drastik gjatë protestës: Jo për paratë, por për dinjitetin tim**

**Ekskluzive/ "Auditim në SHISH pas arrestit të Vlora Hysenit", zbardhen diskutimet në Këshillin e Sigurisë. Çfarë thanë kreu i SPAK dhe Kryeministri Rama**

**Ngacmonte nxënësen 13-vjeçare/ Detaje të reja nga Lushnja, banorët për mësuesin 60-vjeçar: I vendosnim duart në zjarr, ishte njeri i kulturuar**

**Vdekja e Mazonakis hap "kutinë e pandorës", kimioterapi pa licencë në klinikën e Selanikut, hetimet zbulojnë problematikat**

Top Channel

në spital

Liga e Kombeve, rezultatet e mbrëmjes/ Nga zhgënjimi te festivali i golave, Italia kthehet te fitorja, Franca marshon e qetë

VIDEO/ “Unë jam përgjegjës për ferrin tënd”, ministri izraelit i Sigurisë Kombëtare kërcënon të burgosurin palestinez: Fundi yt është…

“Erdhi një listë nga Kosova me…”/ Artan Hoxha në “Top Story”: Vlora Hyseni krijoi rreth të ngushtë, shmangu komunikimin standard

## Ekonomi »



Më shumë bukë dhe sallam, industria shqiptare shënon rënie, më pak kërkesa edhe për eksporte

28/09 16:27



Investimet e huaja ndryshojnë hartën e Shqipërisë/ Kryeson Austria, pronat thithin mbi 600 milionë euro

27/09 19:48



Sezoni i patates në Stëblevë/ Fshati që prodhon deri në 10 mijë tonë, fermerët: Jetojmë vetëm me këtë produkt

27/09 12:37



Fasoneritë kërkojnë ndihmë/ Europa e dobët dhe kostot në rritje, prodhuesit duan ndryshime fiskale për 2027

26/09 12:12



Turizmi ngadalësoi në gusht, në tetë muaj regjistrohen 9.4 milionë hyrje të huajsh, 5.3% më shumë se në 2025

25/09 15:22



Të huajt marrin më pak prona, blerjet nga jo-rezidentët bien nga 25% në 20%, rriten investimet e huaja

24/09 20:21

## Na ndiqni:

Top Channel | @topchannelalbania | @tchbreakingnews | Top Channel

## Video »



Top News – Kokainë dhe hashash. Korçë, katër të arrestuar në dy operacione të policisë



Top Channel/ FMN e Banka Botërore vlerësojnë pozitivisht sistemin financiar shqiptar




Top Channel/ Ndezi zjarr për të djegur mbeturinat, flakët u përhapën, arrestohet 31-vjeçari në Fier



Top News – Vlerësimi i FMN dhe BB, Sistemi financiar shqiptar ‘i shëndetshëm dhe i larmishëm’



Top News- Partitë ende pa emër/ Shtatë ditë afat për zgjedhjen e presidentit të Kosovës



Top News – Egjipti e paralajmëroi tre herë Izraelin / Sulmi i 7 tetorit, Netanyahu: Nuk kisha dijeni



© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.